

Në përputhje me nenin 4 paragrafi 2 të ligjit “Për kontrollin e tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve të rëndësishme strategjike për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës” (Fletorja zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës, numër 103/09) dhe nenin 6 paragrafi 2 të ligjit “Për administratën publike” (Fletorja zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës numër 32/02 dhe 102/09) Ministri i Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike të Bosnjë-Hercegovinës miraton:

LISTËN E MALLRAVE TË PËRDORIMIT TË VEÇANTË

Mallrat e përdorimit të veçantë janë mallrat joushtarake për qëllime tregtare të cilat nuk janë përfshirë në Listën e përbashkët të mallrave ushtarake ose në Listën e mallrave me përdorim të dyfishtë. Mallrat e përdorimit të veçantë, për shkak të karakteristikave të tyre, mund të vënë në rrezik jetën dhe shëndetin e njerëzve, të mirat materiale dhe mjedisin ose sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës dhe për këtë është e nevojshme marrja e dokumentit për tregtinë me jashtë të këtyre mallrave.

PN 1. Armët, municionet, pjesët dhe aksesorët e tyre si vijon:

PN 1.1. Armë zjarri – pushkët, pistoletat dhe revolverët, si dhe të gjitha llojet e pajisjeve të cilat lëshojnë predha (plumba, shtimje, saçme) nën presionin e gazeve, si më poshtë:

- a. revolverët dhe pistoletat që nuk përfshihen në ML1 në Listën e përbashkët të mallrave ushtarake, siç janë:
 1. armët e zjarrit me tytë të shkurtër gjysmautomatike ose me përsëritje;
 2. armët e zjarrit me tytë të shkurtër me një qitje me ndezje qendrore;
 3. armët e zjarrit me tytë të shkurtër me një qitje me ndezje anësore;
 4. pistoletat dhe revolverët për qitje të predhave manovër (plumba qorr);
 5. pistoletat sinjalizuese dhe pajisje të tjera të parashikuara vetëm për lëshimin e raketave sinjalizuese;
 6. armët e tjera;
- b. pushkët sportive, të gjahut dhe qitje sportive si vijon:
 1. armët e zjarrit gjysmautomatike me tytë të gjatë, sportive dhe të gjahut, të cilat bashkë me folenë dhe krehrin mund të pranojnë më shumë se tre plumba
 2. armët e zjarrit gjysmautomatike me tytë të gjatë me fole dhe krehër për jo më shumë se tre plumba, ku foleja ose mekanizimi i mbushjes mund të hiqet, pra kur nuk është e sigurt nëse arma është krijuar në atë mënyrë që të mund të modifikohet përmes mjeteve të zakonshme në armë zjarri me fole dhe krehër për më shumë se tre plumba;
 3. armët e zjarrit gjysmautomatike dhe me përsëritje me tytë të gjatë të vjaskuar me gjatësi totale deri në 60 cm;
 4. armët e zjarrit me përsëritje me tytë të gjatë të cilat nuk janë përfshirë në pikën 3;
 5. armët e zjarrit gjysmautomatike me përsëritje me tytë të gjatë të cilat nuk janë përfshirë në pikën 1 dhe 4;
 6. armët e zjarrit me tytë të gjatë me një qitje të cilat kanë një ose më shumë tyta të pavjaskuara (p.sh. shotgun-et);
 7. armët e zjarrit me tytë të gjatë me një qitje të cilat kanë një ose më shumë tyta të vjaskuara (p.sh. pushkë-shotgun e kombinuar);
 8. armët e zjarrit të cilat mbushen nga pjesa e tytës;
 9. armë të tjera.

- PN 1.2.** Armët të cilat aktivizohen nën veprimin e ajrit të kompresuar ose të gazit të kompresuar, si vijon:
- pushkët me sustë;
 - pistoletat dhe pushkët me ajër;
 - armët me gaz;
 - pistoletat pneumatike për trullosjen ose përgjumjen e kafshëve.
- PN 1.3.** Armët dhe pajisjet e tjera:
- paralizuesit me elektroshok (pajisjet e dorës të cilat e neutralizojnë përkohësisht personin përmes tensionit të lartë elektrik);
 - spërkatësit (sprejet);
 - pushkët për hedhje litari;
 - pajisjet dhe mjetet të cilat përdoren në industrinë e ndërtimit për bashkimin e materialeve të forta, të cilat veprojnë nën presionin e gazeve të barutit).
- PN 1.4.** Municionet dhe pjesët e municioneve për produktet e përmendura në PN 1, PN 1.2. dhe PN 1.3.
- PN 1.5.** Pjesët, aksesorët, pajisjet e veçanta (p.sh. silenciatorët, dylbitë optike për armët e gjahut dhe ato sportive, matësi i distancës me laser dhe të ngjashme) për produktet e përmendura në PN1.1. dhe PN1.2.
- PN 1.6** Imitimet e armëve dhe armët dekorative (p.sh. “airsoft” etj.).
- PN 1.7** Armët me hark, për shembull, harqet, harpunët dhe pajisje të tjera që përdorin forcën e një fijeje të shtrënguar për të gjuajtur me shigjetë apo predhë tjetër.
- PN 1.8** Pajisjet policore, për shembull shkopinjtë e gomës, prangat, mburojat, jelekët antiplumb, helmetat etj.

PN 2 “Materialet që përdorin energji” dhe substancat përkatëse, si vijon:

Shënim: Shih gjithashtu ML8 në Listën e përbashkët të mallrave ushtarake dhe 1C011 në Listën e mallrave me përdorim të dyfishtë.

- Për nevojat e PNI, koncepti i përzierjes lidhet me përbërjen e dy ose më shumë substancave në të cilën të paktën njëra substancë i nënshtrohet kontrollit sipas pikës PNI.*
- Çdo njëra nga substancat e përmendura në PNI është objekt i kësaj Liste edhe kur përdoret në raste të ndryshme nga ato të përmendura (p.sh. lëndët shpërthyese mund të përdoren edhe si lëndë djegëse etj.).*

PN 2.1. “Lëndët shpërthyese” dhe përzierjet e tyre, si vijon:

- lëndët shpërthyese nistore:
 - azid plumbi CAS 13424-46-9;
 - azid argjendi CAS 13863-88-2;
 - azid natriumi CAS 26628-22-8;
 - azid bariumi CAS 18810-58-7;
 - fulminant zhive CAS 628-86-4;

6. fulminant argjendi CAS 5610-59-3;
 7. diazodinitrofenol CAS 4682-03-5 (87-31-0);
 8. stifnat plumbi (trinitrorezorcinat plumbi) CAS 15245-44-0;
 9. guanilnitrosoamino-guaniltetrazen (tetrazen) (TET) CAS 31330-63-9;
- b. lëndët plasëse copëtuese: përzjerje me azot (lidhja kimike -C-NO₂), estere nitrati (lidhja kimike -C-O-NO₂) dhe nitrosamine (lidhja kimike -C-N-NO₂), si vijon:
1. dinitrobenzen CAS 99-65-0;
 2. heksanitrodifenilaminë CAS 131-73-7;
 3. dinitrotoluol CAS 99749-33-4;
 4. tetranitrometan CAS 509-14-8;
 5. tetranitroanilinë CAS 53014-37-2 (509-14-8);
 6. trinitroanilinë CAS 26592-42-1(489-98-5);
 7. trinitrofenol (acid pikrik) CAS 88-89-1;
 8. trinitroksilen (TNX) CAS 632-92-8;
 9. trinitrotoluen (TNT) CAS 118-96-7;
 10. nitrocelulozë CAS 9004-70-0;
 11. dinitrat glikoli dietileni CAS 693-21-0;
 12. dinitrat glikoli etileni CAS 628-96-6;
 13. nitroglicerinë (gliceroltrinitrat) (trinitrat 1,2,3-propan-trioli) (NGI) CAS 55-63-0; CAS 9010-02-0;
 14. tetranitrat pentaeritrioli (pentrit) (PETN) CAS 78-11-5;
 15. etilendinitraminë (EDNA) CAS 505-71-5;
- c. përzjerjet e ndryshme shpërthyesë (lëndët shpërthyesë komerciale): barut, plastikë, me emulsion, të granuluara (lëndët shpërthyesë të përgatitura me bazë nitrati të amonit, klorati dhe perklorati, nitroglicerine, esteresh azoti);
- d. lëndët shpërthyesë plastike me bazë hekszogeni, oktogeni dhe pentriti etj.

PN 2.2. Mbushjet hedhëse (barutet), si vijon:

- a. baruti pa tym (që nuk është renditur në Listën e përbashkët të mallrave ushtarake);
- b. baruti i zi për gjueti;
- c. baruti i zi i minierave;
- d. të tjera.

PN 2.3 Djegoret me djegie të ngadaltë dhe djegoret detonuese.

PN 2.4 Kapsollat goditëse dhe shpërthyesë, ndezësit; detonatorët elektrikë dhe joelektrikë.

PN 2.5. Produktet piroteknike për fishekzjarrë (kategoria I, II, III dhe IV), raketat sinjalizuese, raketat sinjalizuese për mjegull të dendur dhe produktet e tjera piroteknike.

PN 2.6. Raketat kundër breshërive.

Numër: 07-01-02-1623/10.
21 prill 2010
Sarajevë

Ministri
Mladen Zirojević